

1 E enjte, 4 korrik 2024

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

4 --- Seanca fillon në orën 09.00

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sekretare e  
6 Seancës, ju lutem paraqisni lëndën.

7 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar  
8 Gjykatës. Kjo është çështja KSC-BC-2020-06, Prokurori i  
9 Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep  
10 Selimit dhe Jakup Krasniqit.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vërej për  
12 procesverbal që të gjithë të akuzuarit janë të pranishëm në  
13 sallën e gjyqit. Do vazhdojmë me dëshminë e Dëshmitarit të  
14 Prokurorisë W04752.

15 Ju lutem, sillni dëshmitarin në sallë.

16 [Dëshmitari vijon dëshminë]

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjes,  
18 z. Zyrapi.

19 DËSHMITARI: Mirëmëngjesi.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju rikujtoj  
21 dhe një herë t'u përgjigjeni pyetjeve qartë me fjali të  
22 shkurtra. Nëse nuk e kuptoni një pyetje, lirisht kërkoni që  
23 pyetja të përsëritet ose thoni që nuk e kuptoni në mënyrë që  
24 të sqarohet.

25 Flisni pranë mikrofonit, prisni pesë sekonda përpara se

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Bislum Zyrapi (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic (Vazhdim)

Faqe 2

1 të përgjigjeni dhe flisni ngadalë për përkthyesit. Jua  
2 rikujtoj gjithmonë këto, unë e di që ju i keni ndjekur të  
3 gjitha këshillat e mia, por sidoqoftë mua më duhet t' i kujtoj  
4 për procesverbal.

5 Nëse keni nevojë për ndonjë pushim, ju lutem na thoni dhe  
6 do bëjmë organizimin përkatës. Ju rikujtoj që jeni ende nën  
7 betim për të thënë të vërtetën sikurse vetë e cituat përmes  
8 deklaratës solemne.

9 Ju rikujtoj po ashtu që nuk jeni i detyruar t' ju  
10 përgjigjeni pyetjeve që janë vetinkriminuese, me përjashtim të  
11 rasteve kur ua kërkon Trupi Gjykses. Në rast se lind një  
12 pyetje e tillë, përmes Avokatit tuaj, mund ta ngrini këtë me  
13 Trupi Gjykses dhe do të vendosim ne pastaj në ç' rrethana do të  
14 detyroheni për t' u përgjigjur.

15 Do vazhdojmë me pyetjet nga Mbrojtja e Thaçit.

16 Z. Misetic, fjala është për ju.

17 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

18 DËSHMITARI: BISLIM ZYRAPI [Vijon]

19 Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic:

20 [Vazhdim]

21 Z. MISETIC: [Përkthim]

22 PY. Mirëmëngjes, z. Zyrapi.

23 PË. Mirëmëngjes.

24 PY. Dua të filloj me çështjen e riorganizimit të UÇK-së në  
25 nëntor të 1998-s. Por pikësëpari dua të kuptoj parimet që mund

1 të jenë zbatuar ose jo gjatë ristrukturimit.

2 Nga përvoja në ushtrinë jugosllave dhe ushtrinë e  
3 Bosnjës, a jeni i njohur me parimin e një komande të vetme?

4 PËRKTHYESJA: Avokati për procesverbal foli në gjuhën  
5 serbo-kroate.

6 DËSHMITARI: Plotësisht, po.

7 Z. MISETIC: [Përkthim]

8 PY. Parimi është parimi i një komande të vetme dhe vartësisë  
9 në strukturën e një ushtrie?

10 PË. Po.

11 PY. Komanda e vetme dhe komanda dhe vartësia, siç jeni mësuar  
12 ju në akademinë e lartë, a ka qenë një parim që zbatohet në  
13 armatën jugosllave në ushtrinë jugosllave?

14 PË. Po.

15 PY. A ishte ky një parim që u zbatua kur filloi riorganizimi  
16 ose më saktë, a ishte ky një parim që u përpoqet që ta  
17 zbatonit ju dhe z. Sylja gjatë ristrukturimit, pra, të kishit  
18 një komandë të vetme?

19 PË. Përpjekja ka qenë prej fillimit e deri në fund, por nuk  
20 është e njëjtë sikur ta krahasojmë zhvillimin e një komande.

21 Më falni duhet ta shpjegoj këtë se s'mund të jap veç me po ose  
22 jo. Zhvillimi i një komande e cila është një ushtri e rregullt  
23 të cilët janë të përgatitur kudrat me shkollat ushtarake  
24 adekuate me përvojat adekuate për të arritur në nivelin e një  
25 komande të tillë ose komande të unifikuar ose komandë që

1 thojmë na të Shtabit të Përgjithshëm ose një komandë të lart.

2 Ne në këtë drejtim nuk kemi mujt këto parimet t'i kemi,  
3 t'i zbatojmë plotësisht me ato që kam mujt dhe çka kemi mujt  
4 anëtarët të cilët kanë qenë dhe pa përvojë ushtarake, po jo me  
5 -- jo me shkollat ushtarake, me atë dijeni që kanë pasur, me  
6 atë mundësi që kanë pasur, me ato rregulla që kanë mujt t'i  
7 mësojnë ose t'i japin me kaq kanë vepru. Këto në qoftë se i  
8 marrim parimet e një ushtrie të rregullt dhe një komande të  
9 tillë në ushtri të rregullt dhe të kësaj kanë dallime, cek  
10 këto parimet.

11 PY. Po. Fillimisht kjo do të thotë që ka vetëm një komandant  
12 për një zinxhir komandues, kështu, e thënë me pak fjalë?

13 PË. Po.

14 PY. Gjatë ristrukturimit Azem Syla, me sa keni ju dijeni, ka  
15 qenë komandant i përgjithshëm. Pra, ai ka qenë kreu i  
16 komandës, kreu i zinxhirit komandues, kështu?

17 PË. Po.

18 PY. Më pas kishte nivele më të ulëta, por Shtabi i  
19 Përgjithshëm i raportonte Azem Sylës, kështu?

20 PË. Po, i raportonte në rregull parimet.

21 PY. Ju, mesa kuptova unë nga dëshmia juaj, merrnit urdhra dhe  
22 udhëzime nga Azem Syla për hapat e radhës, kështu?

23 PË. Po, në atë kohë kur ka mujt të marrë, kur ka qenë brenda  
24 ose kur ka dërgu, por jo çdo herë.

25 PY. Do flasim dhe për një shembull më konkret dhe ju i keni

1 dhënë dëshmi lidhur me këtë se si jeni konsultuar me z. Sylja  
2 përpara se të merrej një vendim.

3 Por ne sidoqoftë vazhdojmë për momentin. Në çështjen  
4 Milutinovic, ju e keni përshkruar rolin që kishit si kreun e  
5 administratës së Shtabit të Përgjithshëm ku përfshihen masat  
6 disiplinore dhe detyrat e tjera përkatëse. A ju kujtohet kjo?  
7 Nëse nuk ju kujtohet atëherë unë mund t'ua lexoj. Madje më  
8 saktë po ua lexoj për të qenë i drejtë me ju.

9 Ju është kërkuar të përshkruani postin që kishit: Ju keni  
10 thënë:

11 "Si shef shtabi, ndër detyrat e tjera përfshihej  
12 përgatitje për të rritur nivelin e personelit në UÇK të  
13 operacioneve, masat disiplinore, çështje logjistike,  
14 prokurimesh, gatishmëria e lart e stafit dhe e gjithë  
15 personelit të UÇK-së. Me pak fjalë këto kanë qenë detyrat."

16 Kështu ka qenë?

17 PË. Po, kështu kam thënë, kështu janë një ndër detyrat.

18 PY. Siç e kuptoj unë ristrukturimin, drejtoritë e Shtabit të  
19 Përgjithshëm ishin në varësinë tuaj si shef i shtabit, kështu?

20 PË. Po.

21 PY. Ju gjatë intervistës me ZPS-në keni dëshmuar dhe kjo  
22 është në provën materiale P01355, Pjesa 3, faqja 38, ju keni  
23 thënë, pra, meqë UÇK-ja në nëntor të 1998 merrej dhe me  
24 përfaqësues ndërkombëtarë në negociatat politike, i duhej një  
25 organ politik për t'u përfaqësuar me ndërkombëtarët. A ka

1 ndodhur kështu?

2 PË. Po, pikërisht ashtu ka ndodhur dhe ashtu ka fillu  
3 organizimi -- riorganizimi.

4 PY. Në këtë intervistë i keni thënë ZPS-së se riorganizimi  
5 lidhej shumë me bisedimet dhe lidhjet që kishte krijuar UÇK-ja  
6 me komunitetin ndërkombëtar, saktë?

7 PË. Saktë.

8 PY. Tani, në nëntor të 1998-s, ju a prisnit, kishit  
9 parashikuar që do të ndodhte një ofensivë serbe në pranverën e  
10 1999?

11 PË. Ne në atë kohë kemi -- së pari jemi marrë me  
12 riorganizimin. E dyta, me ndihmat gjithnjë janë të operativës  
13 së Shtabit të Përgjithshëm të mendon në mbrojtje. Po në  
14 ofensivat e mundshme që mund të ndodhin, për arsye se ne në  
15 atë kohë tetor, nëntor, dhjetor e këto ditë, në këtë kohë që  
16 ishte pushim, armëpushimi, po armëpushimi ishte i njëanshëm  
17 nga ana ynë, kështu që nuk pritshim bash që do të respektonin  
18 serbët këtë armëpushim. Dhe për arsye gjithnjë kemi mëndu dhe  
19 një operacione të tilla të mbrojtjes të planifikohen të  
20 organizohen të përgatiten.

21 PY. Në gjykimin Milutinovic në provën materiale P01356, ju  
22 keni thënë që gjatë dimrit të 1998 dhe 1999, forcat e UÇK-së  
23 ishin "ende në zhvillim e sipër". A është ky një vlerësim i  
24 saktë?

25 PË. Po, plotësisht është i saktë.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Bislir Zyrapi (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic (Vazhdim)

Faqe 7

1 PY. A ju kujtohet një rast në dhjetor të 1998-s që të kishe  
2 të bënte me komandant Remin në linjën e Podujevës që shkaktoi  
3 ç'ka -- domethënë dhe ky incident nxiti ndërkombëtarët  
4 përfshirë këtu Shaun Byrnes, që të përpiqeshin ta bindnin  
5 komandant Remin të tërhiqte forcat nga Podujeva, nga linja e  
6 Podujevës? Ju kujtohet ky incident?

7 PË. Po, më kujtohet.

8 PY. A ju kujtohet që drejtoria operative e Shtabit të  
9 Përgjithshëm, pra, a ju kujtohet që komandant Remi nuk i  
10 dëgjonte kërkesat që i drejtonte drejtoria operative e Shtabit  
11 të Përgjithshëm për të tërhequr forcat nga linja e Podujevës,  
12 vija e Podujevës?

13 PË. Po, është e saktë.

14 PY. A është ky një shembull që tregon apo që ilustron  
15 vështirësitë që kishit ju ende me komandantët e zonës në  
16 dhjetor sepse ata ende nuk dëgjonin urdhrat apo udhëzimet që  
17 vinin nga drejtoria operative?

18 PË. Po, është e vërtetë.

19 PY. Përafërsisht nga mesi i nëntorit 1998 deri në fillim të  
20 marsit 1999, e keni parë ju fizikisht z. Thaçi në Kosovë?

21 PË. Jo, deri në kohën kur është kthyer prej Rambujesë.

22 PY. A e dini ju ku ishte z. Thaçi jashtë Kosovës nga mesi  
23 nëntorit 1998 e deri në fillim të marsit 1999?

24 PË. Prej asaj kohës së nëntorit, dhjetorit ai ka qenë jashtë  
25 Shqipërisë dhe që ka pas këto bisedimet me aspekte

1 ndërkombëtare, me ndërkombëtarët që ishte duke u përgatitur  
2 për takim faktikisht edhe mbledhjen e Rambujesë e cila u mbajt  
3 pastaj në shkurt. E di që në këto drejtime është, ka qenë ka  
4 punu dhe është ka veprue.

5 PY. Gjatë procesit të ristrukturimit i thatë ZPS-së se e  
6 ndatë Shtabin e Përgjithshëm në dy grupime, grupimi operativ  
7 dhe grupimi politik, kështu?

8 PË. Po, nuk ndahet Shtabi i Përgjithshëm në dy grupe. Po  
9 pjesa politike është ndajtur, të vepron me aspektet e  
10 ndërkombëtare dhe me ndërkombëtarët si dhe vëzhguesit që ishin  
11 mbrena në Kosovë, si me OSBE-në, si me gjithë të mirret kjo  
12 drejtori dhe ky grup i pjesës politike. Kurse çështjet  
13 ushtarake është çështje ushtarake dhe të mirret me çështje  
14 ushtarake.

15 PY. Pra, grupi politik merrej me negociatat me  
16 ndërkombëtarët, kështu?

17 PË. Po, me negociatat.

18 PY. Dhe grupi politik nuk përfshihej në çështje ushtarake, a  
19 është kështu?

20 PË. Po, ashtu është.

21 PY. Ka qenë grupi operativ i Shtabit të Përgjithshëm edhe ju  
22 si shef shtabi dhe drejtori të tjera që ishit të angazhuar për  
23 përgatitjen e operacioneve luftarake, trajnimeve, përgatitjes  
24 profesionale, kështu?

25 PË. Po. Pikërisht q'ashtu është.



1 PY. I thatë ZPS-së në Shënimin Përgatitor 2, paragrafi 22, se  
2 ju personalisht nuk përfshiheshit në çështjet politike dhe se  
3 merreshit vetëm me aspektet ushtarake, kështu?

4 PË. Po. Pikërisht.

5 PY. Në 2008 në gjykimin Haradinaj, i keni thënë Trupit  
6 Gjykues se nga maji deri në shtator operacionet luftarake nuk  
7 autorizoheshin paraprakisht nga Shtabi i Përgjithshëm në asnjë  
8 vend të Kosovës, a është saktë?

9 PË. Po, saktë [E pakuptueshme].

10 PY. Gjithashtu i thatë atij Trupi Gjykues në gjykimin e  
11 Haradinaj në 2008 se nga momenti që keni hyrë për herë të parë  
12 në Kosovë e deri kur u larguat në shtator, nuk kishte  
13 komunikime të rregullta mes Shtabit të Përgjithshëm dhe  
14 komandantëve të zonave, a është kështu?

15 PË. Po. Kështu është.

16 PY. Para nëntorit të 1998-s, ju personalisht, si komunikoni  
17 me komandantët e zonave?

18 PË. Vështirë ka qenë të komunikohet përveçse në qoftë se kemi  
19 shku, kam shku në atë zonë, kur kam shku në atë zonë atëherë  
20 ose ai ka ardhë ka shtabi që kemi mujt të takohemi. Po ka qenë  
21 vështirë. Nuk kemi pas një komunikim, mjete komunikuese me  
22 telefon, unë personalish po foli, as me radiolidhje. Po ka mujt  
23 vetëm fizikisht të takohem me ta.

24 PY. Por pas ristrukturimit, keni thënë në çështjen  
25 Milutinovic, keni thënë që ka qenë një sallë komunikimi dhe

1 atje kishte një oficer të caktuar për këtë, kështu?

2 PË. Po. Kjo është më pas riorganizimit të Shtabit të  
3 Përgjithshëm kur është bë drejtoria operative, në kuadër të  
4 drejtorisë operative është ndërtuar salla operative të cilën  
5 në atë sallë janë marrë të gjitha raportet nga zonat, janë  
6 përpunuar dhe janë dhënë komandës se çka po ndodhi në ato zona  
7 ose raportime që po vijnë. Po, është e vërtetë kështu ka qenë.

8 PY. Në Trupin Gjykues të Milotinovic në provën materiale  
9 P01356 keni thënë që:

10 "Roli i këtij oficeri ishte të kontaktonte zonat  
11 operative, të mësonte çfarë kërkesash kishin t'ua përcillte  
12 kërkesat shtabit, po dhe t krijonte një panoramë të qartë se  
13 çfarë po ndodhte në gjithë territorin e Kosovës".

14 A është ky një përshkrim i saktë?

15 PË. Po, përshkrim i saktë është i eprorit në drejtorinë  
16 operative.

17 PY. Çështja e telefonave satelitorë. Ju treguan disa  
18 fotografi të telefonave satelitorë nga ana e Prokurorisë gjatë  
19 kohës që po ju bënte pyetje. ZPS-së i keni thënë që telefonat  
20 satelitor për herë të parë UÇK-ja i ka marrë nga dhjetori i  
21 1998-s e më pas në vijim, kështu?

22 PË. Po, nga dijenia jeme.

23 PY. A keni dijeni ju të jenë përdorur telefona satelitorë nga  
24 UÇK-ja para dhjetorit të 1998?

25 PË. Nuk e di. Nuk kam pas raste të tilla me këto telefona të

1 bisedoj apo t'i shof.

2 PY. A është e drejtë të themi që nga mesi i korrikut kur u  
3 bëtë drejtor i drejtorisë operative pranë Shtabit të  
4 Përgjithshëm, vetë drejtoria operative nuk kishte telefon  
5 satelitor, flasim nga mesi i korrikut deri në dhjetor të 1998?

6 PË. Po, ashtu është.

7 PY. Z. Thaçi u përzgjedh të kryesonte drejtorinë politike,  
8 saktë?

9 PË. Saktë.

10 PY. Në intervistën për ZPS-në Pjesa 7, faqja 18, ju keni  
11 thënë që z. Syla dhe të gjithë drejtorët e tjerë e vlerësonin  
12 aftësinë politike të z. Thaçi, kështu?

13 PË. Po, ashtu është.

14 PY. Të flasim përsëri për drejtorinë politike, në Pjesën 7 të  
15 intervistës me ZPS-në, në faqen 15 ju keni thënë që drejtoria  
16 politike nuk ishte në varësinë tuaj si shef shtabi po kishte  
17 varësi tjetër. Kështu ka qenë?

18 PË. Po, ashtu është.

19 PY. Nga sa kuptova unë nga dëshmia që keni dhënë ZPS-së është  
20 që ju keni thënë që z. Thaçi komunikonte drejtpërdrejt me z.  
21 Syla, e kam kuptuar saktë?

22 PË. Po, saktë q'ashtu është.

23 PY. Nga 1998 deri në mars 1999, mesa keni kuptuar ju, z.  
24 Thaçi merrej me aspektet diplomatike, me ndërkombëtarët,  
25 kryente bisedime dhe i raportonte z. Syla, kështu?

1 PË. Po.

2 PY. ZPS-ja ju ka bërë një pyetje dhe pyetja ishte, kjo është  
3 në Pjesën 7, faqja 16 e intervistës suaj, ju ka bërë këtë  
4 pyetje, nëse drejtorja politike e mbikëqyrte vendimet e  
5 komandantit të përgjithshëm për të garantuar që të zbatoheshin  
6 siç duhet. dhe ju i jeni përgjigjur:

7 "Jo, drejtorja politike nuk mbikëqyrte vendimet e marra  
8 nga komandanti i përgjithshëm, pra, nuk verifikonte zbatimin e  
9 tyre."

10 Saktë?

11 PË. Po, e saktë është shumë.

12 PY. A është e vërtetë, siç keni thënë në intervistën për ZPS-  
13 në, që drejtorja politike nuk vepronte si një lloj organi  
14 civil për mbikëqyrjen e veprimtarisë së UÇK-së?

15 PË. Po, ashtu kam thënë.

16 PY. Në intervistën për ZPS-në po në Pjesën 7, në faqen 22 dhe  
17 në faqen 23, ju është bërë një pyetje nëse ka pasur kontroll  
18 civil mbi UÇK-në dhe ju i jeni përgjigjur:

19 "Nuk ka pasur një kontroll të tillë. Kontrollin e kishte  
20 komandanti i përgjithshëm".

21 Saktë?

22 PË. Saktë.

23 PY. Siç e kuptoj unë, drejtorja politike u krijua për  
24 bisedimet me ndërkombëtarët, por në momentin që u formua  
25 Qeveria e Përkohshme në mars të 1999, drejtorja politike nuk

1 funksionoi më brenda UÇK-së, kështu?

2 PË. Po, ashtu është.

3 PY. A është e drejtë të them që ju nuk e keni lëshuar asnjë  
4 urdhër z. Thaçi dhe anasjelltas, z. Thaçi nuk ka lëshuar asnjë  
5 urdhër për ju?

6 PË. Po, e saktë është.

7 PY. Në Pjesën 10 të intervistës për ZPS-në, faqja 21, keni  
8 dëshmuar se nuk e dinit kush ishin zëvendësit e z. Thaçi në  
9 drejtorinë politike, kështu ka qenë?

10 PË. Po, ashtu është.

11 PY. Po kjo mos ka qenë për shkak se ju nuk kishit lidhje me  
12 punën e z. Thaçi në drejtorinë politike?

13 PË. Po, pikërisht ajo se nuk jam marrë me atë çështje fare.

14 PY. A është e drejtë të them që ju nuk e dinit kush ishin  
15 zëvendësit e tij sepse dhe ata nuk kishin lidhje me punën  
16 tuaj?

17 PË. Po, pikërisht.

18 PY. Flasim sërish për ristrukturimin. Por do të filloj duke  
19 ju treguar -- dua t'ju tregoj fillimisht një dokument. Dua të  
20 flas tani për masat disiplinore, krijimin e gjykatës ushtarake  
21 dhe sesi u krijua ky sistem.

22 Z. MISETIC: [Përkthim] Por fillimisht do të doja që të  
23 shfaqej në ekran materiali me numër DHT03866 deri në DHT03868.

24 PY. Dëshmitar, ju kërkoj ndjesë, këtë nuk e kemi në shqip në  
25 ekran. Kjo është dëshmia e një personi Zoran Stijovic. Keni

1 dëgjuar ndonjëherë për këtë person?

2 PË. Jo, nuk e di kush është.

3 PY. Ai është një person që ka dhënë dëshmi në ish-Tribunalin  
4 e Hagës publikisht dhe ka punuar për shërbimin e sigurimit  
5 serb. Ai ka dhënë dëshmi dhe ka thënë se sigurimi serb kishte  
6 më së paku 200 burime që do të thotë kolaboracionist brenda  
7 UÇK-së.

8 Keni pasur ju dijeni, të paktën gjatë ristrukturimit që  
9 UÇK-ja të kishte probleme me kolaboracionistët në radhët e  
10 veta?

11 PË. Në atë kohë gjatë ristrukturimit po dhe para saj më së  
12 shumti popullata dhe probleme kemi pas me to, sidomos me  
13 pjesën të cilën disa fshatra janë vesh edhe policë lokale,  
14 sidomos në zonën e Dukagjinit. Dhe më vonë tani nuk di më  
15 tutje, domethënë, se nuk ka qenë e imja të hulumtoj në atë  
16 drejtim. Po me siguri tash nuk po them a do të janë q'aq numri  
17 i tyre, a ka qenë nëpër radha të UÇK-së a jo, se është e  
18 vështirë të thuhet në ato se nuk kam bë një hulumtim të tillë.  
19 Për ato është sektorët e veçanta, është sektori juridik, është  
20 sektori i zbulimit kundërzbulimit që mund t'i ketë ato. Po për  
21 mua nuk mund të them që mund të ketë q'aq se po të ishin q'aq  
22 në kuadër të ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, sigurisht që ne  
23 nuk duhet të ishim sot këtu fare.

24 PY. Së pari më lejoni t'ju bëj një pyetje në lidhje me  
25 personat në zonën e Dukagjinit. A mund të sqarojmë pak më

1 shumë se cili ka qenë problemi me personat që vishnin  
2 uniformat e policisë serbe?

3 PË. Po. Kur folëm ato vishnin si polici lokale në disa  
4 fshatra nëpër regjionin e Dukagjinit. Për ata kanë marrë me  
5 vesh uniformë policisë lokale të Serbisë, domethënë, ajo ka  
6 një barabartë i veshun me uniformë si një ushtar i  
7 kundërshtarit, i armikut dhe a kanë më i rrezikshëm se çdo  
8 ushtar tjetër që ka ardhë të lufton kundra nesh në Kosovë, për  
9 arsye se ata persona na kanë njoft, kanë ditë territorin, na  
10 kanë njoft neve, dhe kanë mujt dhe ma shumë dëme na kanë pru  
11 ata sesa na ka mujt me na pru dikush nga jashtë që ka ardhë të  
12 sulmon ose të na sulmon si njësi nga Serbia apo nga diku  
13 tjetër.

14 PY. Dhe kur vishnin këto uniforma ata, çfarë krijonte  
15 pikërisht probleme në qoftë se ju kuptova siç duhet?

16 PË. Po problemet, këqyrshin dhe lëvizjet tona edhe qëndrimi  
17 ynë në ato territore. Në qoftë se janë të veshur policë lokal  
18 atena u duhshin të konfrontoheshim ne atyne. Për ato dhe  
19 shpesh herë u duhte të largoheshim nga ato fshatrat ose të  
20 ishin shumë më larg tyre. Dhe na më tepër ishte pengesë e  
21 lëvizjes edhe e jona edhe zhvillimit më tutje në ato  
22 territore.

23 PY. Në rregull. Ju përmendët tani që kjo ishte një gjë për  
24 gjykatën ushtarake dhe për kundërzbulimin, po më lejoni ta  
25 diskutoj tani këtë me ju.

1 Me TPNJ-në në 2005 në dëshminë tuaj, në paragrafin 37,  
2 SPOE00183317 deri në 18342, thoni që nuk ka patur gjykatë  
3 ushtarake në UÇK deri në fund të 1999. Është e saktë kjo?  
4 PË. Si mendoni? Deri në fund të? Edhe një herë pyetjen, ju  
5 lutem?

6 PY. Po. Ju keni thënë që nuk ka patur gjykatë ushtarake në  
7 UÇK deri në fund të 1999? Më kanë thënë që po thuhet "1999".  
8 Po duhet të jetë 1998.

9 PË. Pikërisht kjo ishte dhe pse ndala të mendoj 1999, diçka  
10 tjetër. Po, në 1998. Ashtu është.

11 PY. Faleminderit. Ju keni dëshmuar tek ZPS-ja në Pjesën 4, në  
12 faqen 12 të intervistës tuaj, që gjatë muajve të verës kur ju  
13 keni shkuar në shtabe të ndryshme lokale si dhe gjatë javëve  
14 të para pasi u kthyet në Kosovë nëntor të 1998, ju keni marrë  
15 një sërë ankesash nga komandantët e zonave për sjelljet e  
16 ndryshme në zonat e tyre si dhe për mungesën e rregullave dhe  
17 të urdhrave nga më lartë për t'u trajtuar këto çështje, është  
18 e saktë kjo?

19 PË. Po.

20 PY. Dhe i keni thënë ZPS-së në Pjesën 4, faqja 19 të  
21 intervistës tuaj, që kur i dëgjuat këto ankesa ju ia keni  
22 raportuar ato komandantit të përgjithshëm, z. Sylja, a është e  
23 saktë kjo?

24 PË. Po, e saktë është. Në kohën kur ka qenë këtu.

25 PY. Në nëntor dhe dhjetor të 1998, a kishit dijeni për



1 informacion nga ndërkombëtarët si, për shembull, nga Shaun  
2 Byrnes që edhe ata raportonin shqetësimet e tyre tek Shtabi i  
3 Përgjithshëm në këtë kohë për mungesën e disiplinës?  
4 PË. Po, disa, disa raste.  
5 PY. Dhe kur them "ndërkombëtarët" besoj që e dini që Shaun  
6 Byrnes ose KDOMI ose OSBE-ja ose Kryqi i Kuq ose Human Right  
7 Watch? Këta për këto çështje kishin dhe ata informacion dhe po  
8 e raportonin, e saktë?  
9 PË. Po, më kujtohet pak.  
10 PY. Pasi u bëtë shef shtabi, UÇK-ja filloi që t'i qasje --  
11 akses OSBE-së dhe ICRC-së për të hyrë dhe për takuar, vizituar  
12 personat që ishin ndaluar. Ju vetë, në fakt, a keni inkurajuar  
13 komandantët e zonës që ta lejonin këtë gjë?  
14 PË. Nuk më kujtohet. Përveçse kur kemi qenë me komandantin e  
15 zonës së Shalës po. Kur jam pyet, për tjerat nuk më kujtohet.  
16 Nuk jam pyet për atë.  
17 PY. Në rregull. Po a e dini se pse OSBE-ja ka patur mundësi  
18 që të hyjë, të ketë akses tek të ndaluarit, për shembull, në  
19 zonën e Llapit? Ky ka qenë vendim i komandant Remit apo mund  
20 të ketë qenë diçka që ka ardhur nga ju si shef i shtabit?  
21 PË. Jo. Në këtë rast pak e di shumë. Ky rast është i  
22 komandant Remit. Dhe nuk është -- më duket është dhe me  
23 përfaqësuesin politik Adem Demaçin ka qenë kjo çështje të  
24 cilët të dytë kanë biseduar dhe Remi ka lejuar që të  
25 vizitohen. Nuk ka pas të bëjë me shtabin këto fare, as me mu,

1 as me anëtarë -- ndoshta me anëtarë të shtabi tjetër, nuk di,  
2 por që unë kam dijeni që jo.

3 PY. Në rregull. Si pjesë e riorganizimit, ju keni qenë  
4 personi që merrej me shqetësimet që ju kishin sjellë  
5 komandantët e zonës juve, e saktë?

6 PË. Po.

7 PY. Dhe për rrjedhojë ju keni lëshuar një urdhër ose  
8 urdhëresë.

9 Z. MISETIC: [Përkthim] Dhe do t'ju lutesha ta vendosnim  
10 në ekran. Ka numrin 1D29. Dhe anglishten, ju lutem, me numrin  
11 SPOE00119161 deri në SPOE00119161-ET I Rishikuar.

12 Z. EMMERSON: [Përkthim] Është e pranuar si prova 1D00029-  
13 ET.

14 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Nuk ka qenë në listën e  
15 dokumenteve që do të prezantoheshin. E kam fjalën për  
16 përkthimin në anglisht.

17 Z. MISETIC: [Përkthim] Atëherë nëse mund ta lexojmë me  
18 këtë numrin që ju dhashë unë të cilin e kemi vendosur tek  
19 lista e materialeve.

20 PY. Dëshmitar, a njihni këtë urdhëresë?

21 PË. Po.

22 PY. A është kjo urdhëresa që keni lëshuar ju në 28 nëntor të  
23 1998 duke reaguar ndaj informacioneve që kishit marrë, pra, në  
24 përgjigjet e tyre për mungesën e disiplinës tek ushtarët e  
25 UÇK-së?

1 PË. Po, pikërisht.

2 PY. Në pikën 4 të kësaj urdhërese thuhet:

3 "Ndalohet arrestimi, paraburgimi ose burgosja e personave  
4 pa urdhër të komandantit të brigadës a më lart, vetëm në  
5 rastet kritike të situatave luftarake apo kur kryhen vepra të  
6 ndryshme penale si ndaj pjesëtarëve të UÇK-së, ndaj individëve  
7 apo pushtetit civil".

8 Përse e keni përfshirë pikën 4 në urdhëresën tuaj?

9 PË. E kam përfshi për arsye se ka pas ankesa të tilla edhe ma  
10 herët. Dhe është përfshi kjo pjesë meqë ishim dhe në kohën e  
11 armëpushimit dhe ishim në kontakt dhe me ndërkombëtarët që të  
12 disiplinohen çdo ushtar. Se ka pasë dhe ushtarë të cilët kanë  
13 qenë ende edhe pse ishin në riorganizim, po kishte hala edhe  
14 grupe të cilën nuk ishin nën komandë të plotë për të  
15 disiplinuar dhe ato grupe dhe ushtarët që të mos sillen në  
16 krye në vete.

17 PY. Po. pra, në përgjigjen tuaj ju thatë që "kemi patur  
18 kontakte me ndërkombëtarët". Kjo urdhëresë u bë në përgjigje  
19 të ankesave që kishit marrë edhe nga ndërkombëtarët?

20 PË. Kur folim kjo urdhëresë të cilën me komandantin e  
21 përgjithshëm e kemi bë, është që janë bë ankesa dhe  
22 komandantëve, po dhe civilëve, po edhe ndërkombëtarët.

23 PY. Në rregull. Dëshmitar, po më paralajmërojnë që kam folur  
24 shumë shpejt dhe do të përpiqem që të flas më me ngadalë, jo  
25 vetëm për Gjykatën, por edhe për përkthyesit.

1 Në pjesën 6 ose pikën 6 thuhet:

2 "Ndaj kryesve të veprave penale apo shkelësve të  
3 disiplinës ushtarake, të ndërmerren masa të menjëhershme  
4 izolimi, çarmatimi dhe përcjellja në organet e gjyqit ushtarak  
5 të UÇK-së".

6 Atëherë referenca këtu që i bëhet "gjyqit ushtarak",  
7 gjyqi ushtarak me ç'dini ju u krijua edhe për t'u marrë me  
8 çështjet e disiplinës ushtarake si edhe me ata që kanë kryer  
9 vepra penale, autorët e këtyre veprave?

10 PË. Po në përgjithësi sektori juridik në atë kohë është formu  
11 për qëto çështje, për masat të cilat mund të ndodhin edhe  
12 disiplinore por dhe ato vepra të rënda.

13 PY. Ju i keni thënë ZPS-së në Pjesën 5 dhe faqen 10 të  
14 intervistës tuaj me ta deh do ta lexoj tani që:

15 "Përpara se të lëshohej kjo urdhëresë, ne kemi organizuar  
16 një takim në Shtabin e Përgjithshëm dhe u diskutua aty që  
17 mënyra sesi po ecnin gjërat dhe sesi merreshin me to në  
18 veçanti për kolaboracionistët, do të thoshte që çdo veprim  
19 prej tani e tutje do të duhet të ndiqte procedurën ligjore.  
20 Dhe sektori juridik do të vendoste në se ky personi ishte apo  
21 jo kolaboracionist dhe të vendosej nëse dikush kishte qenë ose  
22 jo autori i veprës penale"

23 Është e saktë kjo?

24 PË. Po, e saktë edhe kjo është.

25 PY. Pra, pjesë e kësaj urdhërese, sipas dëshmisë tuaj, është

1 që edhe në rast se dikush dyshohej se ishte kolaboracionist ju  
2 dëshironit që ky person të kalonte te drejtoria juridike që të  
3 merreshin ata me këtë çështje?

4 PË. Po, po. Pikërisht ashtu është.

5 PY. Pyetja që ju bë ishte "Kush kanë qenë të pranishëm në  
6 këtë takim të Shtabit të Përgjithshëm ku u diskutua kjo  
7 çështje?" në Pjesën 5 të intervistës tuaj, në faqen 11 të saj.  
8 Ju nuk keni identifikuar z. Thaçi si të pranishëm në atë  
9 takim, është e saktë kjo?

10 PË. Po, e saktë është.

11 PY. Pra, dikush duhej të emërohej si kreu i gjykatës  
12 ushtarake dhe ju i thatë ZPS-së në Pjesën 13 -- jo, më falni,  
13 jo ZPS-së. Po është në fakt në provën 1356 te TPNJ-ja në faqen  
14 136, rreshti 16 deri në 18, në pyetjen:

15 "Kush e emëroi z. Dobruna në këtë post?"

16 Përgjigja juaj ishte që:

17 "U kërkua që të krijohet gjykatë ushtarake dhe pas një  
18 propozimi nga komandanti i përgjithshëm, kështu u bë emërimi i  
19 tij".

20 Pra, së pari, personi që u emërua ishte Sokol Dobruna, e  
21 saktë?

22 PË. Po, e saktë.

23 PY. Dhe ai u emërua me propozimin e z. Sylja, e saktë kjo?

24 PË. Po të komandës dhe normalisht edhe propozim ka qenë edhe  
25 komandantit të zonës të Dukagjinit.

1 PY. I bie që të ishte z. Haradinaj?

2 PË. Po, se nga zona e tij ka ardhë.

3 PY. Dhe z. Haradinaj kur ua bëri ju këtë propozim?

4 PË. Pasi është bë kërkesa që të gjindet një ushtar i cili ka  
5 përvojat juridike ose shkollat juridike dhe ka përvojë në këtë  
6 drejtim, provoja që më adekuat.

7 PY. Sa kandidatë pati, pra, brenda për brenda UÇK-së dhe që  
8 kishin kriteret e duhura ligjore që të ishin në krye të  
9 gjykatës ushtarake, e mbani mend sesa kandidatë ka patur?

10 PË. Jo. Jo, nuk jam marrë me atë çështje.

11 PY. Z. Dobruna ka qenë anëtar i LDK-së, është e saktë kjo?

12 PË. Nuk e di në cilën parti ka qenë më herët.

13 PY. Kur u krijua gjykata ushtarake, synimi a ishte që të  
14 ishte një gjykatë ushtarake e plotë dhe funksionale?

15 PË. Po synimi dhe i vetë ushtrisë dhe çdo ristrukturimi ka  
16 qenë që të bëhet funksionale dhe e plotë, mirëpo ato me  
17 mundësitë dhe kushtet që janë ofru në atë kohë. Ato që ke mujt  
18 t'i bëjmë. Domethënë, synimi ka qenë që të bëhet e plotë, por  
19 asnjëherë s'ka mujt ta rrisim. Prej fillimit kur kemi fillu  
20 t'i ristrukturojmë ose t'i formojmë këto njësi deri në fund të  
21 luftës s'kemi arritun t'i bëjmë të plota.

22 PY. Atëherë ta bëj pyetjen ndryshe: Gjykata ushtarake u  
23 krijua që të dukej sikur UÇK-ja dilte më mirë në sytë e  
24 ndërkombëtarëve?

25 PË. Po dhe të dilte mirë në sytë e ndërkombëtarëve, po dhe te

1 masat disiplinore ndaj vetë dhe pjesëtarëve të saj.

2 PY. Nga njëra anë ishte që të vendosej disiplina, e cila  
3 pastaj hapi tjetër do ishte që do të kënaqte ndërkombëtarët,  
4 është e saktë kjo, e drejtë më saktë?

5 PË. Po, në përgjithësi, po.

6 PY. Pse nuk u krijua më parë një gjykatë ushtarake, për  
7 shembull, më përpara nëntorit 1998?

8 PË. Nuk ka mujt të formohet se dhe vetë Ushtria Çlirimtare  
9 nuk ka qenë aq e formuar në aspektet ushtarake, se ka qenë me  
10 grupe, nuk ka qenë e unifikuar. Nuk ka qenë një sistem  
11 ushtarak i cili ka hy në atë drejtim që të zhvillohet. Ajo ka  
12 qenë ende me grupe, grupe të ndryshme. Edhe gjatë shpjegimit  
13 të këtyre ditëve më herëshme e kam shpjegua sesi ka qenë kur  
14 kam hy unë deri në dhjetor duke u bërë riorganizimi. Domethënë,  
15 nuk ka mujt të bëhet, jo veç gjykatë ushtarake po edhe vetë  
16 shtabi si shtab nuk ka mund të funksionon si shtab ose fillon  
17 ose të ndërtohet si shtab ushtarak domethënë, shumë pak ka  
18 pas.

19 PY. Edhe një herë, armëpushimi në tetor ishte mundësia që ju  
20 tha juve për ristrukturim dhe për të krijuar gjithashtu edhe  
21 procedura efektive për të riparë dhe për të rishikuar, për  
22 shembull, çështjet e ndryshme që kishin të bënin krimin por  
23 edhe me kolaboracionistët?

24 PË. Po, pikërisht kjo kohë na u dha që ne të riorganizohemi  
25 dhe të mund të punojmë në të gjitha këto drejtimet.

1 PY. Po, por a ishte vetëm për shkak të armëpushimit që ju  
2 patët kohën, mundësinë që të krijonit procedurat e duhura  
3 efektive të rishikimit ose të përpiqeshit që të krijonit gjëra  
4 të tilla si, për shembull, krijimin e një gjykate afektive  
5 ushtarake?

6 PË. Po. Unë thashë po. Këtë na ka mundësu krejt dhe për  
7 ristrukturimin edhe për zhvillim edhe formimin e gjykatës. Dhe  
8 çdo send.

9 PY. Ju e dini që z. Thaçi nuk është jurist?

10 PË. Po.

11 PY. Dhe me ç'dini ju, z. Thaçi ka luajtur rol në mbikëqyrjen  
12 e punës së gjykatës ushtarake?

13 PË. Sa më kujtohet mu jo. Dhe s'ka pas mundësinë në atë kohë.

14 PY. A ka patur juristë të tjerë që mund të keni pasur ju ose  
15 Shtabi i Përgjithshëm që të emëroheshin në gjykatë ose në  
16 gjykatën ushtarake përveç Sokol Dobrunës, me ç'dini ju?

17 PË. Nuk e di. E di që dhe një, sa më kujtohet, ka qenë Agron,  
18 më duket, Berisha. Dhe kanë qenë edhe do tjerë, po nuk e di.  
19 Nuk jam marr me atë çështje që të di saktë kush, sa kanë qenë  
20 dhe kush ka qenë aty.

21 PY. Ju ose Shtabi i Përgjithshëm a keni patur më shumë burime  
22 sa ç'mund t'i kishit dhënë, për shembull, gjykatës ushtarake,  
23 domethënë, a kishit më shumë juristë apo para apo personel,  
24 kuadër, për ta bërë atë më efektive?

25 PË. Jo. Unë e thashë edhe më herët që nuk di, nuk kemi -- unë



1 për vete nuk kam pas evidencë sa ka juristë më tutje dhe as  
2 shumë mjete financiare aq sa kemi pas për ne, ashtu qaq janë  
3 ndanë edhe saj, po më tepër nuk di.

4 PY. Në lidhje me urdhëresën që kemi në ekran, këtë urdhëresë  
5 ia keni dërguar të gjithë komandantëve të zonave, është e  
6 saktë kjo?

7 PË. Po, është përcjellë gjithë komandantëve.

8 PY. Dhe në Pjesën 5, në faqen 11 të intervistës suaj të ZPS-  
9 së, ju keni thënë që ju pasi e keni çuar këtë urdhër ju keni  
10 bërë edhe takime personale për sqarime të mëtejshme me ta dhe  
11 sesi duhet ta vini në zbatim. Është e saktë kjo?

12 PË. Po, pas kësaj se kemi pas edhe takime me komandantët e  
13 zonave.

14 PY. Dhe e diskutuat në veçanti këtë urdhër?

15 PË. Jo, në veçanti s'kemi diskutuar shumë këtë urdhër, po  
16 faktikisht u diskutu që ky urdhër është marrë nga komandantët  
17 e zonave dhe që meqë do ta zbatojnë ato.

18 PY. Gjithashtu ZPS-së në Pjesën 4, faqen 6 të intervistës  
19 tuaj i keni thënë që deri në dhjetor të 1998, të gjitha  
20 çështjet që kishin të bënin me disiplinën dhe respektimin e  
21 urdhrave ishin kaluar Sokol Dobrunës si shefin e drejtorisë  
22 ligjore. Është e saktë kjo?

23 PË. Po, e saktë.

24 PY. Pra, ndër detyrat që kishte Sokol Dobruna, ai kishte dhe  
25 detyrën e ekzaminimit të veprave të rënda penale ndërsa gjërat

1 që kishin të bënin me disiplinën me këto merreshin zonat.

2 Është e saktë?

3 PË. Po. Çdo komandant zone masa disiplinore ka marrë vetë si  
4 komandant brigade në brigadën e vet, komandanti i zonës në  
5 zonën e vet.

6 PY. Për procesverbal e keni thënë këtë në Pjesën 4, faqja 23  
7 të intervistës tuaj me ZPS-në. Dhe Prokuroria ju ka pyetur për  
8 të sqaruar se për çfarë e kishit fjalën kur keni thënë për  
9 vepra të rënda penale. Dhe përgjigja juaj në faqen 24, në  
10 fakt, në faqen 22, është që:

11 "Veprat e rënda penale ishin ... dhe e sqaroj kur merrej  
12 një civil, pra, arrestimi i civilit. Maltrajtimi i civilëve.  
13 Dhe gjithashtu nëse një ushtar apo komandant kishte shkelur  
14 rregullin duke përdorur armën, në veçanti në pikat e  
15 kontrollit, ose kishte shkelur urdhëresat ... nga eprorët e  
16 tyre ... këto konsideroheshin vepra të rënda penale ..."

17 Pra, në rastin e arrestimit të një civili, ju thatë që  
18 kjo nuk ishte çështje për komandantin e zonës por një çështje  
19 me të cilën merrej Sokol Dobruna, është e saktë kjo?

20 PË. Po, ashtu e kam thënë.

21 PY. Dhe këtu përfshihej edhe sistemi që ishte krijuar duke  
22 patur parasysh edhe pjesa e ndalimit që ishte, në fakt, që  
23 ishte krijuar në nivel të Shtabit të Përgjithshëm në Lladrovç,  
24 është e saktë kjo?

25 PË. Po.

1 PY. Tani dëshiroj t'ju tregoj një dokument.

2 Z. MISETIC: [Përkthim] Me numrin P613. Ju lutem vendoseni  
3 në ekran.

4 PY. Dëshmitar, ju lutem shiheni këtë dokument në ekran. A e  
5 keni parë më parë këtë dokument? Nuk është i nënshkruar.

6 PY. Jo, asnjëherë.

7 PY. Në dukje është një dokument në të cilin ku keni  
8 ekzaminuar një ankesë që është bërë në 10 dhjetor 1998 në  
9 lidhje me një ushtar që ishte dënuar. E shihni këtë gjë?

10 PË. Po, po e shof. E kam lexu.

11 PY. A keni nënshkruar ndonjë dokument të tillë ndonjëherë,  
12 mbani mend diçka të tillë?

13 PË. Çka mbaj mend, asnjëherë.

14 PY. A keni luajtur rol me ankesat që janë bërë në formë  
15 apeli, pra, në gjykatën ushtarake keni patur rol?

16 PË. Jo, në qoftë se u bë ankesë ka ardhë nga unë edhe e kam  
17 drejtu në sektorin juridik dhe që është marrë pastaj sektori  
18 juridik, mvarësisht prej kërkesës çka është dhe ankesës.

19 PY. Për shembull, një ushtar që ishte i pakënaqur me një  
20 dënim që ishte dhënë nga gjykata ushtarake, a mund të vinte  
21 tek ju për këtë çështje me ankesën, me një apelim po themi?

22 PË. Jo, do shkonte në sektorin juridik, prej sektorit juridik  
23 në komandë. Komanda pastaj vazhdonte.

24 PY. Me ç'dini ju kush ka patur përgjegjësinë e krijimit të  
25 këtij sistemi të drejtësisë ushtarake dhe sesi do të

1 funksiononte ai?

2 PË. Sektori juridik.

3 PY. Që i takon Sokol Dobruna?

4 PË. Po.

5 PY. Pra, ai vendoste sesa gjykata do të kishte, kështu?

6 PË. Sigurisht se është sektori juridik dhe ai është  
7 profesionist i këtij drejtimit, nuk jam unë. Sa do të kishte  
8 ose do të ishin ato ajo është e tij.

9 PY. Që ta kemi për procesverbal, ju vetë nuk keni eksperiencë  
10 si jurist apo formim si jurist?

11 PË. Jo, aspak. As e kam profesion.

12 PY. Po ndonjë personit në Shtabin e Përgjithshëm me  
13 përjashtim të Sokol Dobrunës, kishte formim si jurist?

14 PË. Çka di si jurist ka qenë Fatmir Limaj në këtë drejtim ka  
15 pas këtë njohuri ose këtë drejtim shkollimi.

16 PY. I keni thënë ZPS-së në Pjesën 4, faqja 8 e intervistës  
17 suaj se Sokol Dobruna ka qenë përgjegjës për veprimtaritë e  
18 përditshme të objektit të ndalimit në Lladrovç, kështu?

19 PË. Po. Po, është ashtu.

20 Z. MISETIC: [Përkthim] Më falni, po shoh orën i nderuar  
21 Kryegjykatës. Nuk e di a do bëjmë pushimin?

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do bëjmë  
23 dhjetë minuta pushim, Dëshmitar, tani.

24 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Bëjmë dhjetë

1 minuta pushim.

2 --- Seanca ndërpritet në orën 10.02

3 --- Seanca rifillon në orën 10.11

4 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,  
5 sillni dëshmitarin në sallë.

6 [Dëshmitari vijon dëshminë]

7 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull,  
8 Dëshmitar. Do të vazhdojmë me pyetjet nga z. Misetic.

9 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

10 PY. Z. Zyrapi, vazhdojmë aty ku e lamë. Për diskutimin për  
11 punën e Sokol Dobrunës.

12 Në Pjesën 4, faqja 21, i keni thënë ZPS-së kur ju ka bërë  
13 një pyetje, pyetja ishte pra: A kishte z. Dobruna burime për  
14 të garantuar disiplinën nga pikëpamja ligjore në gjithë  
15 Kosovën? Dhe ju jeni përgjigjur:

16 "Ne i dhamë me aq sa mundeshim burime logjistike."

17 Kështu?

18 PË. Po, ashtu është.

19 PY. Flasim tani për policinë ushtarake. I keni thënë ZPS-së  
20 që ndër strukturat që po krijoheshin në kuadër të  
21 riaorganizimit ka qenë edhe policia ushtarake. Saktë?

22 PË. Po, saktë.

23 PY. Po ashtu i keni thënë ZPS-së në Pjesën 5 se policia  
24 ushtarake ishte e ndarë në dy nivele, një nivel -- një në  
25 nivel të Shtabit të Përgjithshëm dhe një në nivel zone.

1 Kështu?

2 PË. Po.

3 PY. I keni thënë ZPS-së, Pjesa 5, faqja 22 se:

4 "Detyra kryesore e policisë ushtarake e Shtabit të  
5 Përgjithshëm ishte të kujdesej për Shtabin e Përgjithshëm, t'i  
6 mbronte gjatë udhëtimeve, gjatë kohës që shkonin e vinin drejt  
7 komandës, ndërsa policia ushtarake në zona kishte për detyrë  
8 që të mbronte zonën e tyre, komandën e tyre dhe i raportnin  
9 komandantëve të tyre sa i takon aspektit të sigurisë."

10 Kështu?

11 PË. Po. Pikërisht.

12 PY. Po ashtu keni thënë që policia ushtarake në nivel të  
13 Shtabit të Përgjithshëm ishte gjithashtu përgjegjëses të  
14 ekzekutonte urdhrat e Sokol Dobrunës të lëshuara prej sektorit  
15 juridik?

16 PË. Po.

17 PY. Këtu përfshihej edhe urdhri që i lëshonte Sokol Dobruna  
18 policisë ushtarake të Shtabit të Përgjithshëm për ta arrestuar  
19 një person. Kështu?

20 PË. Po. Pikërisht.

21 PY. Nëse Sokol Dobruna donte që të arrestohej dikush ai vinte  
22 tek ju dhe pastaj ju ja jepnit këtë detyrë policisë ushtarake  
23 apo Sokol Dobruna shkonte drejtpërdrejt te policia ushtarake?

24 PË. Jo, nuk ka shku përmes meje.

25 PY. Pra, shkonte drejtpërsëdrejti tek drejtorja e policisë

1 ushtarake?

2 PË. Po. Sa më kujtohet [E padëgjueshme].

3 PY. Policia ushtarake në nivel zone i raportonte policisë  
4 ushtarake -- drejtorisë së policisë ushtarake pranë Shtabit të  
5 Përgjithshëm?

6 PË. Jo, policia ushtarake e zonave operative i ka raportuar  
7 komandantit të zonës. Me drejtorinë policia ushtarake ka pasur  
8 në qoftë se ka pat për trajnime, për pajisje, për çështje të  
9 rregullave. Po si aspekte komanduese, komandantit të zonës.

10 Z. MISETIC: [Përkthim] Dua të tregoj një provë me numër  
11 P9-ET faqja U000-3206 deri në U000-3206. Me të njëjtin numër  
12 është edhe shqipja.

13 PY. Dëshmitar, ky është një dokument që duket të jenë  
14 rregullat e përgjithshme të policisë ushtarake. Shohim pikën  
15 4. Thuhet:

16 "Organet e policisë ushtarake varen nga drejtoria e  
17 policisë ushtarake e cila emëron komandantët në nënzonat  
18 operative të policisë ushtarake."

19 Me sa keni ju dijeni, a ka funksionuar në të vërtetë  
20 kështu policia ushtarake në UÇK?

21 PË. Jo, nuk ka funksionuar kështu, dhe kur i lexoj këto  
22 rregullat, se këto rregulla kur i kanë përkthye nga gjuhës  
23 angleze, në atë kohë kur i kemi marrë si përshkrim detyrash me  
24 numër 4, domethënë, ky -- kjo detyrë nuk ka qenë e përkthyme  
25 dhe nuk ka qenë [E pakuptueshme]. Se qysh është -- kush e ka

1 vendos pastaj këtë pikë këtu, nuk e di, por kur njëherë nuk  
2 është bo kjo që detyra operative të përcakton komandantin e  
3 policisë ushtarake në zona po më poshtë. A ka mund të jep një  
4 mendim gjatë trajnimit të tij apo përgatitjes së tij se sa  
5 është i përgatitur, po, ama për të përcaktuar jo.

6 PY. Bazuar në përgjigjen që sapo dhatë, ju i keni autorizuar  
7 -- e keni autorizuar ju këtë rregullore? Këto që shohim në  
8 ekran.

9 PË. Unë thashë rregulloret i kam përgatitur të gjitha për çdo  
10 drejtori kur i kam bërë përkthimet edhe -- mirëpo, që kjo pikë  
11 nuk ka qenë në atë kohë kur unë i kam përkthi. Këtë e kam  
12 thënë edhe ma herët, edhe në çdo gjykatë. Ka është [E  
13 pakuptueshme] kush e ka shkru këtu masanej, e ka vendos, nuk e  
14 di.

15 PY. Dëshmitar, dua t'ju pyes për diçka shkurtimisht. I keni  
16 thënë ZPS-së gjatë seancë përgatitore, pra, ku përgatiteshit  
17 për të ardhur këtu, keni thënë se keni emëruar Kurtesh Fondaj  
18 si ushtrues i detyrës së komandantit të Brigadës 123. Kështu?

19 PË. Në shtator 1998.

20 PY. A ju kujtohet se si e keni emëruar?

21 PË. Po, në atë kohë me gojë se s'ka pas me shkrim kurrëfarë.  
22 S'kemi pasë mundësi kanë qenë luftimet dhe në atë kohë kur  
23 është emëruar si ushtrues detyrë se është çështja për shkak se  
24 komandanti i kësaj njësie është larguar nga territori i  
25 Kosovës nga njësia, dhe ky si shef shtabi i asaj njësie ose



1 brigade, atëherë unë kam vendosur që ta ushtron kryesi i  
2 detyrës komandantit të brigadës derisa nuk bëhet zgjidhje  
3 tjetër, faktikisht derisa nuk kthehen nga Shqipëria.  
4 PY. Një çast ju lutem.

5 A keni marrë pjesë ju fillimisht në krijimin e Brigadës -  
6 - më falni. Mos -- nuk, nuk bën kjo pyetje. Do të bëj një  
7 pyetje tjetër. Flasim për shkurtin e 1999 dhe fundin e janarit  
8 1999.

9 Z. MISETIC: [Përkthim] Shohim në ekran materialin  
10 SPOE00226468 [Sipas përkthimit] deri në SPOE00226480-ET në  
11 faqen SPOE00226476.

12 PY. Dëshmitar, i keni parë ndonjëherë më përpara këto  
13 shënime, këtë shënim? Pretendohet se është një shënim i një  
14 mbledhje të Shtabit të Përgjithshëm më 28 janar 1999. A e  
15 shihni?

16 PË. Po, e shoh.

17 PY. Këtu duket sikur është bërë një diskutim -- do të jap  
18 edhe kontekstin fillimisht. Është mbajtur një mbledhje në  
19 fillim të bisedimeve të Rambujesë, kështu?

20 PË. Me siguri, po nuk më kujtohet ky takim që kam qenë. Se  
21 këtu flitet edhe për çështjen edhe takimit edhe Rambuje edhe  
22 përfaqësuesit ndërkombëtarë.

23 PY. Nuk ju kujtohet që të jetë bërë një diskutim ose që të  
24 keni qenë në një mbledhje ku jetë diskutuar -- ku të jetë  
25 diskutuar emërimi, caktimi i një grupi politik të UÇK-së për

1 këto bisedime?

2 PË. Ajo është tjetër. Grupi politik [E pakuptueshme] po a ka  
3 qenë në këtë takim a në takim tjetër, nuk e di.

4 PY. Bazuar në atë që keni thënë më herët, që z. Thaçi nuk ka  
5 qenë në Kosovë në këtë kohë, kush mund të ketë qenë nga Shtabi  
6 i Përgjithshëm në këtë mbledhje për të diskutuar çështjet  
7 politike me aq sa ju kujtohet ju?

8 PË. Sa më kujtohet në atë kohë, këtu kur kemi diskutu për  
9 çështje se çfarë po ndodh, këtu na ka informuar për shembull  
10 për -- me ndërkombëtarët bisedat ose për Rambuje, na ka  
11 informu në atë kohë Jakup Krasniqi.

12 PY. Keni dijeni a kanë marrë [pjesë] komandantët e zonave në  
13 një takim të kësaj natyre?

14 PË. Nuk e di, veç atë datë -- nuk e di. Por takimet, po, kanë  
15 qenë kur është dashtë të informohet ose të bisedohet për  
16 çështjet e Rambujesë apo është -- janë takimet që janë mbajt  
17 edhe me komandantët e zonave, po a është ky takim, nuk e di.

18 PY. Flasim për një takim tjetër.

19 Z. MISETIC: [Përkthim] Besoj se është në të njëjtin  
20 dokumentin në fakt që shohim në ekran. Numri është  
21 SPOE00226477. Takimi mban datën 1 shkurt 1999.

22 PY. A ju kujtohet të keni qenë i pranishëm në një takim më 1  
23 shkurt 1999 ku tema të diskutimit kanë qenë diskutime rreth  
24 takimit të Rambujesë, konsultime me komandantë të zonave,  
25 konsultim me partitë politike?

1 PË. Po, më kujtohet.

2 PY. A ju kujtohet kush ka qenë i pranishëm në këtë takim?

3 PË. Për momentin, jo. Zakonisht në këto takime si është  
4 thënë, kanë qenë anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm. Apo kanë  
5 qenë -- nuk e di, edhe komandant ka qenë ndonjë. Nuk e di. Veç  
6 zakonisht ne, anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm.

7 PY. A ju kujtohet për çfarë ka qenë diskutimi? A ka qenë  
8 konkretisht për Rambujenë, a ka pasur ndonjë pakënaqësi?

9 PË. Në këtë kohë ka qenë për diskutim për takimin për si po  
10 ndodh në Rambuje dhe si po shkon në Rambuje. Pastaj ka qenë  
11 edhe konsultimi, domethënë, këto pika tjetër që a kon -- veç  
12 një pikë a kon e rendit të ditës, diskutim për Rambuje edhe  
13 është konsultim me komandantët e zonave për mendimin se si po  
14 shkon rrjedhjat në Rambuje. Edhe do të thotë me partitë  
15 politike, domethënë me subjekte politike.

16 Unë më kujtohet që ka pas diskutime për ato që të  
17 diskutohet se si është gjendja, do të thotë se si po shkon në  
18 Rambuje. Ka pas edhe konsultime edhe me komandantat. Po të  
19 tjerët nuk më kujtohet se kush ka qenë krejt të gjithë këto.  
20 Se në këtë kohë pak më shpesh janë taku edhe shtabet edhe  
21 sidomos grupet aspektet politike për të diskutuar për çështjen  
22 e Rambujesë.

23 PY. Ju thatë se ju kujtohet që janë bërë konsultime me  
24 komandantët e zonave për këto bisedime. A mund të na e  
25 shpjegoni pse duhej që të konsultoheshin komandantët e zonave

1 për negociata diplomatike?

2 PË. Po pikësëpari është se dihet një ndër takimet, nuk është  
3 ky takim, po më vonë kemi pas që ku erdh edhe deri te  
4 ndryshimi i komandantit të përgjithshëm, edhe pos kënaqësia e  
5 komandantëve të zonave, disa komandantë të zonave nuk kanë  
6 qenë të pajtimit që të nënshkruhet Rambujeja menjëherë. Pra  
7 ato është dashtë të konsultohet edhe me gjithë komandantët e  
8 zonave, ndoshta ata edhe një pjesë e shtabit ka qenë të cilët  
9 është dashtë të konsultohet me ta, kanë qenë autoritet në  
10 zonat e veta, për të mujtur me pas edhe mendimet e tyre, për  
11 me mujt delegacioni i Rambujesë të ketë më lehtë të merr  
12 vendimin për nënshkrim apo mosnënshkrimin e marrëveshjes në  
13 Rambuje.

14 Z. MISETIC: [Përkthim] I nderuar Kryetar i seancës, ky  
15 dokument i cili është SPOE00226468 deri në SPOE00226480, dhe  
16 në veçanti faqja SPOE00226477, dorëzohet si provë. Kërkohe të  
17 pranohet.

18 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka  
19 kundërshtime nga Prokuroria?

20 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Vetëm këtë -- nuk kemi  
21 kundërshtim, po vetëm për sqarim, vetëm kjo faqe po dorëzohet?

22 Z. MISETIC: [Përkthim] Për momentin vetëm kjo faqe, po ka  
23 edhe dy faqe të tjera për cilat dëshiroj të bisedoj me  
24 dëshmitarin.

25 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Bislum Zyrapi (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic (Vazhdim)

Faqe 37

1 SPOE00226468 deri në SPOE00226480-ET në faqen SPOE00226477,  
2 pranohet nga Gjykata.

3 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Kjo faqe si edhe  
4 përkthimi në gjuhën angleze do të marrin numrin e provës  
5 materiale 1D00167. Për momentin klasifikimi është  
6 konfidencial.

7 Z. MISETIC: [Përkthim] Mund të jetë publik si klasifikim,  
8 të paktën nga ana jonë.

9 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të  
10 riklasifikohet si dokument publik.

11 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit, i  
12 nderuar.

13 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit, znj. Sekretare e  
14 seancës. Dhe tani të kalojmë te SPOE00226488 në faqen tjetër,  
15 ju lutem.

16 PY. Z. Zyrapi, këto janë shënime nga një takim në datën 4  
17 shkurt 1999. Dhe këtu vazhdohet -- ose më parë më lejoni që  
18 t'ju bëj këtë pyetje. Embani mend që të keni qenë të  
19 pranishëm në një takim ku janë diskutuar këto çështje siç e  
20 shihni në ekran?

21 PË. Po.

22 PY. Pra, platforma politike e UÇK-së për bisedime në  
23 konferencën e Rambujesë, tërheqja e trupave serbe nga Kosova,  
24 diskutime -- pra, keni qenë i pranishëm në këtë takim?

25 PË. Nuk më kujtohet. E di që në takime kemi diskutu edhe për

1 këtë çështje, për Rambj -- edhe për Rambujenë, po ma shumë unë  
2 jam marrë në atë kohë me përgatitjet e këtyre njësive. Me  
3 siguri, po.

4 Z. MISETIC: [Përkthim] Atëherë ju lutem të kalojmë tek  
5 faqja tjetër e cila ka numrin 6479.

6 PY. Këtu është rendi i ditës për një takim në datën  
7 11.02.1999. Dhe në pikën e dytë thuhet:

8 "Krizë organizative në UÇK."

9 E mbani mend -- ose së pari, a e mbani mend që keni qenë  
10 në një takim ku u diskutua një krizë organizative në UÇK?

